



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 14, datë 07/02 /2020

MBI

“PËRCAKTIMIN E PIKËZIMIT NË KONKURSET E PRANIMIT PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenet 74, 76 e vijim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; nisur dhe nga propozimet e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, bashkëlidhur këtij vendimi dhe më konkretisht shkresave të Fakultetit të Muzikës me Nr. 30 prot., datë 28.01.2020, Fakultetit të Artit Skenik me Nr. 25 prot., datë 27.01.2020 dhe të Fakultetit të Arteve të Bukura me Nr. 8 datë 31.01.2020, pasi i diskutoi me votim të hapur,

V E N D O S I:

- I. Pikët maksimale për konkurrim në një nga programet e studimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **200 (dyqind) pikë**, me këtë ndarje:
 - a) 30% e totalit ose **60 (gjashtëdhjetë) pikë** i takojnë notës mesatare të viteve të shkollimit dhe provimeve të Maturës Shtetërore;
 - b) 70% e totalit ose **140 (njëqind e dyzet) pikë** i takojnë rezultateve të konkursit të pranimit për secilin program të ofruar nga Universiteti i Arteve;
2. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor të jetë **90 (nëntëdhjetë) pikë**.
3. Formula e llogaritjes së pikëve të konkursit të pranimit në Universitetin e Arteve për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor në vitin akademik 2020-2021, të jetë si më poshtë:

- | | | |
|---------------|---|--|
| a) P | Pikët e përgjithshme për konkurrim: | 200 totali |
| b) NMP | Nota mesatare e përgjithshme ose 30 % e totalit të pikëve: | 60 pikë |
| c) PK | Pikët e konkursit të pranimit ose 70 % e totalit të pikëve: | 140 pikë |
| d) | Formula e llogaritjes së pikëve: | $P = (NMP/60 \times 0.3 + PK/140 \times 0.7) \times 200$ |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

4. Pikët maksimale për konkurrin në një nga programet e studimit në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor, dhe Master Profesional në Fakultetet e Universitetit të Arteve të jenë **100 pikë**.
5. Ndarja e pikëve për të tre fakultetet e UART të jetë si më poshtë:
 - a) Nota mesatare e ponderuar: **30** (tridhjetë) pikë;
 - b) Vlerësimi i dosjes personale: **30** (tridhjetë) pikë;
 - c) Bashkëbisedim me kandidatin: **40** (dyzet) pikë;
6. Kufiri minimal i pranimit të konkurrentëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve/ Master Shkencor, dhe Master Profesional për të tre fakultetet në UART, të jetë **40 pikë**.
7. Ky vendim të dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
8. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në portalin U-Albania dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Asoc. Genc MULLIQI

Urim ALIAJ

Rajmond PRENDUSHI



nr. 81/Prot
29.01.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANATI

Nr. 25 prot.

Tiranë, më 27.01.2020

Lënda: *Mbi konkurset për pranimin e studentëve në dy ciklet e studimit për vitin akademik 2020 - 2021*

Drejtuar: **ZV./REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**
Prof.dr. Erald BAKALLI

Z. Bakalli!

Mbështetur në shkresën Tuaj nr. 81 Prot., datë 29.01.2020 po ju dërgojmë propozimet e departamenteve të FAS për miratim në Senatin Akademik.

1. -Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e parë të studimeve bachelor për vitin akademik 2020- 2021 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë 200 pikë. (Dyqindë)
2. Ndarja e pikëve në këtë cikël të studimeve në përqindje të jetë në dy zëra si më poshtë :
 - a- 30 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore.
 - b- 70 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga rezultatet e Konkursit.
3. Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore të jenë 60 pikë.
Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140 pikë.
4. Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallur si fitues në ciklin e parë të studimeve bachelor të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë.
5. -Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e dytë të studimeve Master për vitin akademik 2019- 2020 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Artit Skenik të jenë 100 (njëqindë) pikë.
6. Vlerësimi për këtë cikël të studimeve ka në bazë dy faza:
 - a- Faza e parë: shqyrtimi i dosjes së kandidatit përbëhet nga dy vlerësime:
 - Nota mesatare e ponderuar 30 (tridhjetë) pikë



- Shqyrtimi i dosjes personale 30 (tridhjetë) pikë
- b- Faza e dytë: bashkëbisedim me kandidatët. Vlerësimi maksimal për këtë fazë është 40 (dyzetë) pikë.
7. Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, të jenë 40 dyzetë) pikë.
8. Formula e llogaritjes së pikëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor të jetë si më poshtë:
- P pikët e përgjithshme në konkurim 200 pikë
 - NMP nota mesatare e përgjithshme ose 30% e totalit të pikëve 60 pikë
 - PK pikët e konkursit të pranimit ose 70% e totalit të pikëve 140 pikë
 - Formula e llogaritjes së pikëve: $P=(NMP/60 \times 0.3 + PK/140 \times 0.7) \times 200$

Bashkangjitur po ju dërgojmë edhe:

- Propozimin për miratimin paraprak të kuotave të pranimit për dy ciklet e studimit për vitin akademik 2020-2021
- Propozimin për miratimin paraprak të tarifave për të dy ciklet e studimit

Ju faleminderit!

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skenografi –Koreografi,

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Aktrim –Teori Arti,

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Regji – Regji Filmi & TV,

Zv/Dekani i FAS

Prof. Ilir MARTINI

Prof.Asoc.Dr.Elida RAPTI

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Gazmend Gjoka

DEKANI

Prof. Petrit MALAJ

FAKULTETI I ARTIT SKENIK



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I MUZIKËS
DEKANI

Nr. 30 prot.

Tiranë, më 28.01.2020

Lënda: Mbi konkruzet e pranimit për dy ciklet e studimit për vitin akademik 2020-2021

Drejtuar: ZV.REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

I nderuar zoti Zv.Rektor !

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 81, datë 22.01.2020, mbi Konkursat e pranimit për vitin akademik 2020-2021, duke marrë në konsideratë edhe mendimet e përgjegjesave të njësisë bazë porpozjme si më poshtë:

1. Kufiri maksimal i pikëve për konkursat e pranimit 2020-2021 në të gjitha programet e studimit të Fakultetit të Muzikës të jetë 200 pikë (dyqindë).
2. Ndarja e pikëve në këtë cikës të studimeve në përqitje të jetë në dy zëra si më poshtë:
 - a- 30 % e pikëve të shumës maksimale (200 pikë) të jenë nga nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provirneve të maturës shteterore.
 - b- 70 % e pikëve të shumës maksimale (200 pikë) nga rezultatet e konkursit.
3. Nisur nga totali i pikëve që propozojmë si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm del që pikët maksimale të fituara nga nota mesatare e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provirneve të maturës shteterore të jenë 60 pikë. Ndërsa pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140.
4. Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallur si fitues në ciklin e parë të studimeve bachelor të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë.
5. Formula e llogaritjes së pikëve për ciklin e parë të studimeve Bachelor të jetë si më poshtë:

P --> Pikët e përgjithshme të nevojshme për rankim

NMP --> Nota mesatare e përgjithëshme sipas VKM

PShM --> Pikët nga mesatarja e Shkollës së Mesme: 30% e 200 pikëve, pra 60 pikë (mesatarja 10)

PK --> Pikë konkursi: 70% e 200 pikëve, maksimumi i pikëve 140

Pragu me 90 pikë

Formula:

Tek - H

(baras) shënim: 6 del nga:

=G2*6 60 : 10

(baras) =

Tek -

Sum(H2;I2)



6. Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e dytë të studimeve Master për vitin akademik 2020-2021 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Muzikës të jenë 100 (njëqind) pikë.
7. Ndarja e pikëve për secilin element kryhet nga komisioni i vlerësimit.
8. Pikët minimale që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, të jetë 40 (dyzetë) pikë.
9. Propozimi për përcaktimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron fakulteti i muzikës në ciklin e parë të studimeve bachelor gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.1.
10. Propozimi për përcaktimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron fakulteti i muzikës në ciklin e dytë të studimeve master gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.2.
11. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron fakulteti i muzikës në ciklin e parë të studimeve bachelor gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.3.
12. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron fakulteti i muzikës në ciklin e dytë të studimeve master gjendet bashkëlidhur kësaj shkrese në tabelën Nr.4.
13. Përsa ju takon pikave 7 dhe 8, janë jashtë kompetencave tona përsa kohë kanë të bëjnë me kosto financiare të studimeve për të dy ciklet.

Me konsideratë,

Përgjegjës i Njesisë Bazë të Interpretimit Prof. Arben Llozi

Përgjegjës i Njesisë Bazë të KMDP-së Prof. Asoc. Dorian Çene

Përgjegjës i Njesisë Bazë të Kantos Prof. Asoc. Kastriot Tusha

Zv.dekan i Fakultetit të Muzikës Prof.Asoc. Merita Rexha (Tërshana)



DEKANI

Prof. Dr. Isak Shehu

FAKULTETI I MUZIKËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA
DEKANI

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2020

Lënda: *Mbi konkurset për pranimin e studentëve në dy ciklet e studimit në FAB për vitin akademik 2020 - 2021*

Drejtuar: **ZV./REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**
Prof.dr. Erald BAKALLI

Z. Bakalli!

Mbështetur në shkresën Tuaj nr. 81 Prot., datë 22.01.2020 po ju dërgojmë propozimet e departamenteve të FAB për miratim në Senatin Akademik.

1. Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e parë të studimeve **Bachelor** për vitin akademik 2020-2021 në të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura të jenë 200 (dyqindë) pikë.
2. Ndarja e pikëve në këtë cikël të studimeve në përqindje të jetë në dy zëra si më poshtë:
 - a- 30 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga nota mesatare e viteve të shkollimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore.
 - b- 70 % e pikëve të shumës maksimale të jenë nga rezultatet e konkursit.
3. Nisur nga totali i pikëve që propozojmë, si dhe nga ndarja e përqindjeve të të dy zërave të mësipërm, rezultojnë se **pikët maksimale të fituara nga nota mesatare** e viteve të studimit të shkollës së mesme dhe provimeve të maturës shtetërore duhet **të jenë 60 pikë**.
Ndërsa **pikët maksimale të fituara nga konkursi i pranimit të jenë 140 pikë**.
4. **Pikët minimale** që duhet të marrë një konkurent për t'u shpallur si fitues në ciklin e parë të studimeve bachelor **të jenë 90 (nëntëdhjetë) pikë**.
5. Formula e llogaritjes së pikëve për ciklin e parë të studimeve Bachelor të jetë si më poshtë :

P - Pikët e përgjithshme të nevojshme për rankim

NMP- Nota mesatare e përgjithshme sipas VKM



PShM - Pikët nga mesatarja e Shkollës së Mesme: 30% e 200 pikëve, pra 60 pikë (mesatarja 10)

PK - Pikë konkursi: 70% e 200 pikëve, maksimumi i pikëve 140

Pragu me 90 pikë

Formula:

(baras) shënim: 6 del nga 60

Tek-H =G2*6 :10
(baras)=

Tek – J Shum(H12;12)

6. -Pikët maksimale në konkurset e pranimit në ciklin e dytë të studimeve **Master** për vitin akademik 2020-2021 në të gjitha programet e studimit në FAB të jenë 100 (njëqind) pikë.
7. Vlerësimi për këtë cikël të studimeve:
 - a- **Shqyrtimi i dosjes së kandidatit përbëhet nga dy vlerësime:**
 - Nota mesatare e ponderuar **30** (tridhjetë) pikë
 - Shqyrtimi i dosjes personale **30** (tridhjetë) pikë
 - b- **Bashkëbisedim me kandidatët.**
Vlerësimi maksimal për këtë fazë është **40** (dyzetë) pikë.
8. **Pikët minimale** që duhet të marrë një konkurent për t'u pranuar si fitues në ciklin e dytë të studimeve Master, të jenë **40** (dyzetë) pikë.
9. Propozimi për përcaktimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron fakulteti FAB, në ciklin e parë të studimeve bachelor, gjëndet bashkëlidhur kësaj shkrese **në tabelën nr.1.**
10. Propozimi për përcaktimin paraprak të kuotave në konkurset e pranimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron FAB në ciklin e dytë të studimeve master, gjëndet bashkëlidhur kësaj shkrese **në tabelën nr.2.**
11. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron FAB në ciklin e parë të studimeve bachelor gjëndet bashkëlidhur kësaj shkrese **në tabelën nr.3.**



12. Propozimi për përcaktimin paraprak të tarifës së konkurrimit, tarifës së regjistrimit si dhe të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2020-2021, për të gjitha programet e studimit që ofron FAB në ciklin e dytë të studimeve gjëndet bashkëlidhur kësaj shkresë në tabelën nr.4.
13. Përsa ju takon pikave 7 dhe 8 të shkresës Tuaj nr. 81 Prot., datë 22.01.2020, duke qenë se kemi të bëjmë me zëra ekonomike dhe elementë të tjerë financiarë e organizativë që mundësojnë përcaktimin e vlerës monetare të studimit për të dy ciklet, po ju dërgojmë një gjykim tonin paraprak, i cili mendojmë se duhet të shqyrtohet nga Drejtoria Ekonomike dhe, më pas të caktohen tarifa unike për gjithë Universitetin.

Në krahasim me vitin paraardhës akademik, duke marrë parasysh edhe zhvillimet e fundit studentore, si edhe kapacitetin e pamjaftueshëm të infrastrukturës mbështetëse për Ciklin e Dytë Master, kuotat e pranimit kanë pësuar ulje.

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Pikturë

Përgjegjësi i Njesisë Arte të Aplikuara

Përgjegjësi i Njesisë Bazë Skulpturë

Zv/Dekani i FAB

Prof. Asc. Edmond Gjipopulli

Prof.AsoAsc. Albes Fusha

Lektor. Ergys Krisiko

Petraç Papa

PROF. ASOC. ARDIAN ISUFI

DEKAN

FAKULTETI ARTEVE TË BUKURA